



Republika e Kosovës
Република Косово / Republic of Kosovo
Qeveria / Влада/ Government
Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министарство за заједнице и повратак /
Ministry of Communities and Return

Fushë Kosovë, datë, 06.02.2023

Në mbështetje të kapitullit III të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin nr.03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtareve të tyrë në Republikën e Kosovës, Ligjin nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, shtojcën 14 të Rregullores (QRK)-nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në Vendimin për përcaktimin e procedurave për ofrimin e ndihmës për pjesëtarët e komuniteteve në Republikën e Kosovës, Ministria për Komunitete dhe Kthim, shpallë:

**THIRRJE PUBLIKE PËR MBËSHTETJEN ME MATERIAL NDËRTIMOR PËR
PJESËTARET E KOMUNITETEVE JO SHUMICË PËR TË CILËT NDIHMA ËSHTË E
NEVOJSHME**

Kjo thirrje publike ka për qëllim ofrimin e mbështetjes nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (me tej MKK-ja), për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës për të cilët ndihma është e nevojshme, duke iu siguruar dhe ndarë material ndërtimor familjeve apo individëve që për arsye ekonomike dhe sociale jetojnë në kushte të vështira.

Kriteret për mbështetjen me material ndërtimor për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë për të cilët ndihma është e nevojshme , janë si në vijim:

- 1) Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe të jenë të moshës mbi tetëmbëdhjetë (18) vjet (të posedoj dokument identifikues të Republikës së Kosovës);
- 2) Gjendja e rëndë ekonomike;
- 3) Të ketë shtëpi ose objekt banimi që është i nevojshëm për renovim që të mund të jetojë në të;
- 4) Aplikuesi apo ndonjëri prej anëtareve të familjes të mos ketë përfituar në tri vitet e fundit ndihmë për ndërtimin e shtëpis/banesës apo renovimin nga ana e MKK-së apo Institucionet dhe organizatat tjera.

Dokumentacioni i cili duhet të dorëzohet:

1. Aplikacionin/Kërkesen (shkarko në web) të plotësuar më të gjitha të dhënat dhe të nënshkruar nga ana e aplikuesit;
2. Kopjen e Letërnjoftimit për aplikuesin dhe anëtarët e tjerë të moshës madhore të familjes;
3. Certifikatën e lindjes për anëtarët e mitur të familjes;
4. Deklaratën mbi bashkësinë familjare;
5. Deklaratën nën betim (shkarko në web) që në tri vitet e fundit nuk ka përfituar ndihmë për ndërtimin apo renovimin e shtëpisë/banesës (e nënshkruar nga ana e aplikuesit);
6. Dëshminë që është nën asistencë sociale (nëse është e aplikueshme);
7. Dëshminë mbi të ardhurat mujore nën pagën mesatare (nëse është e aplikueshme);
8. Dokumente tjera mbi gjendjen shëndetësore të aplikuesit apo anëtareve tjerë të familjes (nëse është e aplikueshme).

Informata plotësuese

Prioritet në kushte të barabarta duhet të kenë kategoritë si në vijim:

- 1. Përfituesit potencialë me familjar në nevoja të veçanta;*
- 2. Përfituesit potencialë me familjar në gjendje të rëndë shëndetësore;*
- 3. Përfituesit potencialë me fëmijë nën moshën 5 vjeçare;*
- 4. Përfituesit potencialë pa të ardhura apo të cilët përfitojnë nga skema e asistencës sociale;*
- 5. Përfituesit potencialë me paaftësi mentale apo fizike;*
- 6. Prindërit vetë ushqyese.*

Vëmendje:

Përfitues do të jenë personat fizik që janë renditur më pikë më të larta nga komisioni vlerësues, varësisht prej limiteve buxhetore të planifikuara. Të gjithë përfituesit obligohen që ndihmën e pranuar ta përdorin për qëllimin e kërkuar.

Periudha e aplikimit:

Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në web faqen e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim <https://mkk.rks-gov.net/> . Të gjitha informatat e nevojshme dhe formularët për aplikim në këtë thirrje publike, mund t'i gjeni si në këtë web faqe gjithashtu mund t'i gjeni në ndërtesën e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim. Aplikuesit që dëshirojnë të aplikojnë sipas thirrjes publike duhet të shprehin interesimin e tyre duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin në kopje fizike në zyrën e arkivit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Rr. Nëna Terezë, pn. 12000 Fushë Kosovë/ Republika e Kosovës.

Paraqitja në këtë thirrje publike fillon me dt. 06.02.2023 kjo thirrje do të jete e hapur deri me dt. 17.02.2023, në orën 16:00 dhe aplikimet pas këtij afati nuk pranohen.

Informacione dhe sqarime shtesë mund të merren direkt nga zyrat e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.